REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**

**KËSHILLI I BASHKISË**

Datë 30.11.2023 Prot.12 (dymdhjetë)

Protokoll nr. 12

I mbajtur sot më datë 30.11.2023, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës,vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. P-V "Mbi miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin tetor 2023" ;
4. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë nga fondi social";
5. P-V "Për miratimin e dokumentit të Politikave dhe Planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Maliq për periudhën janar-dhjetor 2024";
6. Informacion mbi funksionimin e Këshillit Vendor Rinor në Bashkinë Maliq.
7. Diskutime të tjera.

**Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Petrit Kupe; Rudina Bregu; Eriseld Jonusllari;Pranvera Begolli;Enida Avdolli; Dritan Çami; Aramando Dautllari; Marianthi Avrami; Xhuana Hoxhallari;Danjela Ibrahim; Ronaldo Skënderi; Faslli Zholi; Aleksandra Spaho; Albina Xhejo; Idlir Limllari; Neresida Shindo; Server Xhuti; Yllson Ibrahimllari; Almir Elezi; Ilia Xhuti; Dalina Krekas 23 (njëzeteëetre) këshilltarë.

**Të pranishëm nga Administrata:**

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Specialiste e Sektorit të Turizimit dhe Rekeracionit;Totiljana Hajdini; Specialiste e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Agathia Ngjela; Totiljan Hajdini; Specilaliste e Rinisë Bashkia Maliq.

**Enida Avdolli:**Përshëndetje!Jemi mbledhur në mbledhjen e radhës të Këshillit të bashkisë, me materialet jeni njohur parprakisht, së pari verifikojmë korumin duke bërë apelin.Mungesa:Gentiana Drabo, Ornildi Demollari, Rovena Terolli, Fevri Sherifi, Plator

Çollaku, Eglantina Balli, Andonaq Risto, Lulëzim Hoxhaj, Andonaq Risto.Kuorumi realizohet kemi 23 Këshilltarë në sallë.Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, para se të vazhdojmë me rendin e ditës, do doja që te pika diskutime të tjera, të shtojmë një P-V i cili paraqitet emergjent, kemi të bëjmë me djegjen e një banese në fshatin Plasë, do doja mirkuptimin e Këshilltarve ta futim në rend dite sot dhe ta kalojmë për miratim.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Kemi banesën në fshatin Plasë, por do doja mirkuptimin e Këshillit, për dy banesa që janë djegur ditën e djeshme në fshatin Pendavinj që ti kalojmë në mbledhjen e sotme.Është një fond rreth 1 milon lekë të reaj, fond nga Emergjencat Civile, nuk janë fondet tona, fonde të cilat digjen në fund të vitit, do i kërkoja Këshillit ti kalojmë për efekt të likujdimit të pasojave nga rënia e zjarrit në të tre banesat, për të cilat do zbatohen aktet ligjore në fuqi, mbi dëmtimin e orendive shtëpiake që mbulohen 100% dhe 50% dëmtimi i banesave.Shumë faleminderit!

**Enida Avdolli:**Ka ndonjë pytje diskutim rreth kësaj?

**Petrit Kupe:**Është vendosur që do bëhen zgjedhje për Kyetrar fshati atje ku nuk janë bërë, ka kaluar gati një muaj dhe nuk janë bëre akoma, të vendosim një datë për ato fshatra që kanë ngelur.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Shqetësimi është me vend, besoj se këtë duhet ta ndjekë Këshilli i bashkisë, çfarë do ndihme të duhet nga ne jemi të gatshëm tju ndihmojmë me mjete, pjesë kancelarie dhe lista.Për sygjerim, në mbledhjen e radhës të vijë një P-V me të gjitha zgjedhjet dhe të dyja grupet të marrin masa të mbyllen zgjedjet e pleqësive atje ku nuk janë zhvilluar, pas mbledhjes të diskutohet ku ka probleme dhe çfarë është bërë dhe të zgjidhet.

**Yllson Ibrahimllari:**Unë nuk besoj se ka nevojë të priet mbledhja e radhës, Kryesia e këshillit në koordimin me dy kryetarët e grupeve respektive dhe me ndonjë sygjerim nga individët e pavarur, të bien dakord dhe është e zgjidhur, pse duhet të shkojmë deri në mbledhjen e radhës që mund të jetë në fund të muajit Dhjetor dhe na kap viti tjetër për zgjedhjet, të gjitha të mbyllen brenda një fund jave.

**Enida Avdolli:**Duke e lenë që kjo të diskutohet nga Kryesia e këshillit, mund të vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës?

Kush është dakord me rendin e ditës? Me shtesat e P-V "Për dhënie ndihme financiare", E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 23 vota pro
Kundra? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka

Miratohet 23 vota pro. Faleminderit!Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;Ku janë marrë pesë vendime me karketer normativ që kanë marrë dakortësinë e prefektit dhe pesë vendime me karketer kolektiv.
Jemi dakord me proceverablin me mbledhjes së kaluar?
Kush është dakord ? 23 vota pro
Kundra? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka
Miratohet 23 vota pro. Faleminderit!
**Enida Avdolli:**Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës, P-V "Mbi miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin  tetor 2023" ; Ka dikush ndonjë pyjetje apo diskutim rreth kësaj pike? Po Aleksandra.
**Almir Elezi:**Në listën e muajit të kaluar kishte dida familje që nuk e meritojnë të marrin Ndihmë Ekonomike nga fondi 6%, flas për fshatin Podgorie.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Nuk e di për çfarë emra bëhet fjalë konkretisht, ajo çfarë këshilli miraton, janë familjet të cilat nuk kanë pikë të mjaftueshme sipas aplikimit që çdo kush bën në sistem, midis tyre ata zgjedhin disa familje që i trajtojnë, Këshilltarët të jenë të intersuar të shtojnë familje jo ti heqin, do kishe të drejtë po të thoje që një familje nuk trajtohet edhe pse i takon.Ankesën ta bësh pas mbledhjes te zyra, për të marrë masa urgjente nëse ekziston diçka e tillë.

**Almir Elezi:**Urgjente është problemi i djalit me dializë që nuk gjen dot transport, ai është në nevojë.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Ta ndihmojmë por duhet gjetur mjeti, një pjesë të pagesës që e bën shteti që e ka detyrim ligjor dhe ne të bëjmë diferencën e pagesës, por duhet të gjejmë një të mesme, të bëjmë transport jo vetëm për Podgorien por dhe për Pirgun etj.

**Aleksandra Spaho:**Kam disa muaj që kërkoj për disa sutudentë, që për një vërtetim të ndihmës ekonomike nuk mund të përfitojnë dot bursa, në Tiranë ata kanë shpenzime.E kamë kërkuar të bëhet diçka për këto familje ose nga fondi 3% që e kemi patur ose nga 6%.Fondin 3% e kemi patur për një kohë, ta kishim përdorur për këta studentë.Kemi të bëjme me disa familje me probleme social-ekonomike.

**Faslli Zholi:**Jemi këtu te ndihma ekonomike dhe unë jam dakord me atë që tha Kryetari që jemi një bashki që kanë nevojë 60 % për ndihmë eknomike.Unë e kam më tepër për ata që kanë shkelur rregullat dhe ligjet në përfitimin e ndihmës eknomike.Kam kërkuar që në muajin qershor të më jepet një përgjigje për sa i përket shklejes të ligjit, për mua kjo ka nevojë dhe për hetim, që janë marrë lekët kunravajtje nga X person.Kjo përgjigje nuk më është dhënë asnjëherë dhe kjo më duket e padrejtë, nënvlersohet kërkesa që unë kam bërë dhe në emër të grupit.Ju faleminderit!

**Enida Avdolli:**Ndonjë pyjete tjetër?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Dua të përgjigjem për dy momente, lidhur me vërtetimin për studentët, do isha dakord të përfitojnë sa më shumë stidentë bursa studimi, por për ta përfituar bursën, studentët duhet të plotësojnë kriterin ekonomik.Familjet të aplikojnë të dalin me pikë të pamjaftueshme dhe ne ti miratojmë.E dyta në lidhje me kërkesat e grupit të Këshilltarve të opzitës, por jo vetëm të tyre por të gjithë kërkesat, ti depozitojnë te Gerti.Kërkesa që keni bërë duhet të na vijë shkrim që ne tja japim drejtorisë dhe të kthjejë përgjigje.

**Specialiste e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Agathia Ngjela:**Përshëndetje! Dosjen e personit e kam marrë me vete, znj ka aplikuar dhe ka firmosur në datën 08.04.2022, ka bërë një aplikim për ndihmë eknomike, duke qenë se nuk ka marrë pikët e mjeftueshme është rekomanduar për fondin 6%, i cili është miratuar në mbledhjen e Këshillit bashkak, te fondi 6% nuk kryhen vizita në familje, çdo kush ka të drejtë riaplikojë pas një viti, pas një viti duke qenë se zonja nuk është parqitur pranë zyrave të ndihmës eknomike, nuk trajtohet më fondin 6%.

**Faslli Zholi:**Për këtë rast kam edhe fakte konkrete dhe po të doni ja u bëj dhe publike.Lekët e familjes i merr dikush tjetër dhe ky është fakt.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Do pyesja punonjësenm mga cili muaj nuk trajtohet me ndihmë familja?

**Specialiste e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Agathia Ngjela:**Nga muaji Korrik i vitit 2023.

**Faslli Zholi:**Familja ka marrë dhe pagesën e muajit Korrik 2023.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Po them dhe diçka të fundit me ato çfarë keni, unë nuk do të pengojaasnjëri nëse ka një informacion ti drejtohet të gjitha organeve që ai mendon, Drejtorisë Rajonle të Shërbimit Social, Drejtorive apo zyrave në bashki, mua personalisht për raste të tilla dhe nëse mendon që ka dhe dëm eknomik dhe Prokurorisë, nuk asnjë kundërshtim, kush shkel ligjin të përgjigjet.Ndihmën e Eknomike ta marrë ai që i takon.

**Faslli Zholi:**Jam plotësisht dakord, që ky rast të verifikohet.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Mos mbajmë mbledhjen e Këshillit pezull, zyra të sjellë informacion për rastin.Dokumnet me shkrim nuk kemi ende që të kërkoni informacion.

**Enida Avdolli:**Vazhdojmë, tja jap fjalën kolegut.

**Yllson Ibrahimllari:**Për të zgjidhur këtë problematikë që është krijuar prej muajsh.Ju si drejutese e mbledhjes dhe z.Faslli, jeni Kryesia që duhet të na udhiqni, për të na mësaur si të drejtohemi karshi jush, në çfarë rregullore bazohemi. Z.Faslli ka ngritur një ankesë, kërkesë apo konstatim që ka patur, bazoheni në bazë ligjore në rregullore në faen 147 -148, krijohet dhe komisioni i përkohëshëm hetimor, merrni firmat, bëni kormuni vërtetojni dhe e ankimoni.Marrim kriteret e 6% dhe me emra konkret kush nuk plotëson kriteret, dorzoni

kërkesën ka organe të tjera që merren.Kam kërkuar që mbledhja të bëheshe dhe online, ju lutem racinalizoheni dhe pak kohën.

**Enida Avdolli:**Vazhdojmë, e hedhim në votim? P-V Për ndihmën ekonomike.

Kush është dakord ? 23 vota pro
Kundra? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka
Miratohet 23 vota pro. Faleminderit!Kalojmë te pika e radhës e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë nga fondi social";Kemi dy të moshuar në f.Maliq dhe Pirg nga 20.000 lekë, ka ndonjë pyjetje? E kalojmë në votim?
Kush është dakord ? 23 vota pro
Kundra? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka
Miratohet P-V 23 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika e radhës e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e dokumentit të Politikave dhe Planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Maliq për periudhën janar-dhjetor 2024"; Kemi pyetje ose diskutime?
**Pranvera Begolli:**Përshëndetje!Kur kemi bërë trajnimin me BtF, kemi bërë një propzoim që këshilli i bashkisë, mund të jetë i pranishëm për të marrë ekspereincë te Këshilli Bashkiak Shkodër, do doja që të mondësohej një lëvizje e tillë, për të marrë eksperiencë midis dy këshillave.Ju faleminderit!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Nuk kam asnjë kundërshtim, ide është shumë e mirë, Këshilli duhet të bëjë një program si e mendon, duhet bërë dhe kërkesa bashkisë përkatëse dhe jemi në kuadër të hartimit të buxhetit të vitit 2024, ta mendojmë.

**Pranvera Begolli:**Këtë e kemi me buxhetin e vitit 2023.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Ta hapim buxhetin e vitit 2023, nëse ka një zë të tillë jma dakord ta zbatojmë.Dua të shpjegoj dhe binjakëzimin me bashkinë në USA, dua të shpjegoj që jemi në hapat e para, ajo çka Këshilli ka marrë vendim në një mbledhje më parë, tani ka marrë konfirimin dhe nga Institucuini i Prefektit, është një miratim në parim dhe vëretet jam suprizuar që ne po arimë një binjakëzim me një Bashki si motër në USA, ne nuk do paguajmë për këtë binjakëzim, por do kemi vizita të ndërsjellta, por pala më e intersuar jemi ne dhe ku ka më mirë që ne të përfitojmë ekonomikisht, projkete të veçanta, kryetari i bashkisë në USA, ka rënë dakord për të patur shkëmbim eksperinecash në fusha të ndryshme si Bujëqsi, Turizëm etj.Vendimi jonë ka shkuar do vijë dhe vendim i tyre e bordit që ata qujanë, ne do ja u bëjmë prezent të gjithë hapat ligjorë që do merren, të përcaktuara në ligjin për pushtetin lokal, të cilat përcaktojnë, një miratim në parim nga Këshilli i Bashkisë, njoftimi i Prefektit, njoftimi i Minstrisë së Jashtme, për atë se çfarë ne duam të arijmë, nuk bëhen binjakëzime për ato që ne mendojmë, por për ato që lejon kuadri ligjor.Kaq mund tju them për momentin, nuk ka ndonjë ide konkrete, për ato që do preçizojmë në marrveshjet midis bashkive tona.

**Petrit Kupe:**Dua të shtoj dhe unë diçka në vazhdim të asaj që tha Kryeatri, në kuadër të festës së 28 Nëntorit, shumë bashki Arbërshe morrën pjesë në festën e Diasporës, atje midis të tjerash u përmend nga Kryeministri që bashkitë Shqipëtare të binjakëzohen me bashki Arbëreshe, kjo duhet parë si aspketi i marrëveshjes që ka bërë qeveria Shqipëtare duke rakorduar punën me Minstrinë e Jashtme, sepse është ajo që do hartojë litën me bashkitë që do ketë binjakëzohen.Kjo duhet parë gjatë vitit 2024, mirë është binjakëzimi në USA, por kur kemi Arbëreshët, duhet parë dhe në kuadrin e patriotizimit.Faleminderit!

**Enida Avdolli:**Ashtu si është e specifikuar dhe në P-V e Plani i Aktiviteteve ai është dinamik dhe vazhdimisht në proces ndryshimi sipas nevojave dhe kërkesave të Këshillit, po Kryetar.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Sygjerimi është me vend, do isha i hapur për të gjithë që mund të sigurojnë kontakte dhe ne si institucion na takon të bëjmë kërkesa, ne këtë moment që po flasim jemi gati dhe për një binjakëzim me bashkinë e Korinthit në Greqi, ka shkuar propozimi në Minstrinë e Jashtme të Greqisë, patjetër kjo e Arbëreshve është interesante dhe ka të bëjë dhe me pjesën e Shqiptarizimit të themi.Binjakëzimet japim përfitimi të ndërjellta, ndaj dhe unë, dua të jap një falenderim për Platorin dhe Erin si Këshilltarë dhe për një aytetar Shqiptaro-Amerikan nga Sovjani i cili ka bërë këtë urë lidhje në USA dhe unë e quaj këtë një binjakëzim shumë të rëndësishëm, krahëaur me binjakëzimet e tjera që ne kemi patur ndër vite.Jma i hapur për të gjithë që mund të kenë pika kontakti në çdo vend.

**Enida Avdolli:**Vazhdojmë me pikën e radhës? Informacion mbi funksionimin e Këshillit Vendor Rinor në Bashkinë Maliq.Ndonjë diskutim rreth kësaj pike?
**Specilaliste e Rinisë Bashkia Maliq; Totiljana Hajdini:**Po ju jap një informacion ashtu si dhe ju jeni informuar, për mënyrën e funksionimit të kësaj strukure.(dokumneti bashkangjitur)

**Presidenti i Gjmimazit Skëndërbeu Maliq:**Përshëndetje! Dua të ngre shqetësimin për mugesën e kabinateve të informatikës në shkolla, bota po shkon drejt zhvillimi të teknollogjisë dhe shumë maturantë po zgjedhin si degë Informatikën, duke mos patur një kabinet inforamtike ne nuk mund ta praktikojmë dot lëndën.Falimnderit!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Dua ti bëj me dije dhe përfaqësusit të shkollës si President që është se kabinetet e shkollave i mbulon Ministria e Arsimit, por unë mendoj se dhe ne duhet të shikojmë se çfarë kemi mundësi nga fondet tona, nuk është shqetëim vetëm i juaji por kemi disa shkolla me probleme kabinetet e inforamtikës.Do e shohim mundësinë si nga Ministria po ashtu nga fondet tona për të parë mundësin që Gjimanazit i Maliqit të ketë një kabinetet informatike.Faleminderit!

**Enida Avdolli:** Faleminderit!

**Aleksandra Spaho:**Në lidhje me këtë që tha Kryetari i bashkisë, nëse ka ndonjë ndërtesë vetë bashkia ta përshtatë si qendër informatike, biblotekë etj.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Dua të sqaroj diçka, nuk është se shkollat nuk kanë kompjutera, por janë të amortizuar, kur flasim për kabinetete informatike, duhen minimalisht 12 kompjutera që një klasë të bëjë mësim normalisht, ne jemi në proces për marrjen e disa kompjuterave për shkollën, por nuk kemi ende një ndarje ku do shkojnë.

**Enida Avdolli:** Faleminderit!Vazhdojmë me P-V e radhës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë, rënie zjarri në banesë, Z.Tafil Korkuti banues në fshatin Plasë Nj.A Pojan.Kemi ndonjë diskutim?

**Pranvera Begolli:**Kryetari i bëri shpjegim për ndërtesat e dëmtuara dhe kolegët janë dakord ta miratojnë P-V, por kam diçka tjetër, falenderojmë djemtë zjarrfikses, por do doja që stacioni i zjarrëfikesve të kishte një tel fiks, kanë problem dhe tubot e ujit dhe nuk ka idrante në fshatra.Ju faleminderit!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Atë çka është që unë dua të citoj se ne kemi bërë një kërkesë për një numur fiks, ka një problem me ndarjen e territoreve duke qenë se territori i bashkisë Maliq, hyn në disa territore dhe është problem ndarje e fluksit të sinjaleve telefonike, për problmet e tjera që ata mund të kenë, është hera e parë që e dëgjoj, ne kemi fonde për Shërbimin Zjarrëfikës dhe nuk i kemi lënë të mungojë asnjë pajisje, kemi blerë kostume zjarrdurues ndoshta mund të jenë nga më të mirët, që shkojnë 100 mijë lekë.Ne do jemi gjithmonë në mbështetje të tyre, por drejutesi i tyre duhet të sjellë kërkesat.Këshilli ka miratuar fonde, ata kanë fondet e tyre, ne jemi të gatshëm ti mbështesim gjithmonë, por duhet të sjellin specfikimet teknike që ne ti miratojmë në strukturat tona të prokurimeve.Në lidhje me P-V, kemi dy raste një në Plasë për të cilën kemi përmbyllur gjithë praktikën dhe ja u kemi vënë në dispozicion ditën e sotme, është një fond prej 218 mijë lekë, nga të cilat 148.000 lekë janë orendi shtëpiake, të cilat kompesohen 100% dhe 70.000 lekë meremetime të banesës, janë 140.000 lekë por ne kompesojmë 50% dhe në total bëjnë 218 lekë.Vlera 987.000 lekë e ngelur nga fondi i përgjithshëm 1.205.000 lekë që kemi për zjarret, unë mendoj ta kalojmë për banesat e Pendavinjit që u dogjën dje dhe në bazë të praktikës që do sjellë grupi i punës, ne tju bëjmë likujdimin se jemi në prag të dimrit dhe ata duhet të ndërhyjnë urgjentisht për ta stabilizuar situatën e banesave.

**Enida Avdolli:**Jemi dakord ta kalojmë në votim? Duke shtuar dhe familjet e tjera.

Kush është dakord ? 23 vota pro
Kundra? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka
Miratohet 23 vota pro. Faleminderit! Te pika diskutime të tjera kemi diçka?

Diskutime të tjera.

**Aleksandra Spaho:**Shqetësimi i parë vjen nga shoqata e furgonave, linja Podgorie-Vreshtas, ka tre fshatra me linja të lira dhe nuk jepet nga bashkia drita jeshile për lishencën, fshatrat Velitërnë,

Çaushli dhe Leminot.Shqetësimi i dytë e kam përsëri me linjat e furgonave dhe pse nuk lejohen furgonat që vijnë nga Podgoria të futet në Maliq?

**Almir Elezi:**Furgonat nuk respektojnë oraret që kanë.

**Faslli Zholi:**Kam diçla lidhur me rrugën e Moglicës ka probleme, në fshatin Dushar ka mungesë të ujit.

**Floreta Zaçe:**Shqetësim i banorve të Pojanit janë bagëtitë në fushë, ka shumë dëmtime, e dyta është dhe problemi i pazarit në Pojan banorët kanë shqetësim makinat, ky problem të zgjidhet.

**Enida Avdolli:**Kemi diçka tjetër? Po Albina?

**Albina Xhejo:**Përshëndetje! Kisha diçka në lidhje me dy çuna të rinj ka fshati Zvirinë, nuk e di a jeni në djeni, në moshë 17-vjeçare, kanë pësuar aksident në fshatin Velitërn, njëri nga të rinjtë është rëndë në spital, nxënist e shkollës së Pirgut kanë mbledhur një sasi lekësh bashkë me mësuesit, nuk e di sa mundës i ka bashkia ta ndihmojë?

**Almir Elezi:**Kam edhe diçka lidhur me Hidrovorin, deri në çfarë faze është?

**Yllson Ibrahimllari:**Gjatë këtij viti ka patur disa fatkeqësi në zonën e Pojanit, Zvezdë dhe janë bërë vlersime për dëmtimet për të mbjlellat.Nuk e di nga Bashkia është kthyer përgjigje dhe a është disbursuar ai fond për ta? Falimenderit!

**Enida Avdolli:**Kemi diçka tjetër?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Liçensat i kanë të përcaktuara vetë linjat dhe çfarë ata duhet të marrin, nuk i ka prerë as kush të derjtën për të marrë qyetarë në linjat që kanë si ata të Podgories dhe Vreshtasit, në liçensë kanë përveç Vreshatsit dhe Pirgun.Linjat janë të përcakuara si brenda bashkisë dhe jashtë saj, miratohen me Vendim të Këshillit të Qarkut dhe Këshilli i Qarkut, nuk mund të japë leje, për atë të Vreshatsit të marrë pasagjerë në rrugë nacionale.Por ne mund të japim lejë nga Pirgu të shkojë në Korçë.Nga Maliq në Korçë ka linjë autobuzash.Furgonat nuk janë linjë e rregullt si linja e autobuzve me orare, ato janë Taksi.Në Podgorie ka autobuzë me orar nëse ato nuk zbatojnë orarin ta shohim patjetër.Pagesa e Këshilltarve nuk e di që është problem, por do shohim.Bagëtitë në fushë, vëretet është shumë problem, ne po mundohmemi të kemi një nisëm shumë shpjetë, për të bërë një takim me gjithë Blektorët dhe do marrim masa, pasi ky problem nuk është vetëm në Pojan, por në gjithë bashkinë për blekorët në fushë që dëmtojnë pronat e të gjithë qyetarve.Pazarin e Pojanit po mendojmë heqim prej atje, nuk mund të jetë atje në qendër, tani që edhe po invesotojmë për shkollën e re dhe qendrën në përgjithësi, pazarin po mendojmë ta nxjerim në hyrje të Pojanit, ndoshta mund të marrim dhe një vendim Këshilli për vendin.Për rastin e Zvirinë do e shoh me përparësi, të kemi një kërkesë.Për Hidrovorin kemi bërë provën e parë na dhënë rezultat, kemi bërë dhe provën e dytë na ka nxjerrë rreth 200 L ujë në sek, të shpresojmë që do jetë rezultativ jo vetëm për tharjen

e fushës, por dhe rezervimin e ujit në rezervuarin e Podgories.Nuk besoj se ka problem me përmbytje në fushën e Maliqit, do e ndjekim hap pas hapi.Për rastetet e fatkeqësive në Zvezdë dhe Plasë, ka të bëjë me dëmitimin e Mollve dhe disa kulturave bujëqsore, është bërë velersimi nga ana jonë, dëmi ishte më i madh nga çfarë mund të mbulojmë ne me fondet e Emergjencave Civile.Ligji parashikon nëse dëmi shkon në nivele që i mbulon bashkia për efekt të vlerës që ajo ka për Emergjencat Civile, pasi ne kemi 5.6 milon lekë, dëmi atje ishte 10-fish më i madh dhe ju dërgura AKM-së në Tiranë, do shohim sa do arrijmë.

**Yllson Ibrahimllari:**Kompanitë Sigma dhe Sigal, ofrojnë sigurim në fushën e bujqësisë, të kishte një promovim nga bashkia për këtë.Faleminderit!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Sapo na ka ardhur një propozim nga Sigma që bashkia Maliq të jetë projket pilot, ne jemi duke e parë nga ana Jurdike, shpresojmë të jemi mbështetës dhe senzibilizues në këtë pjesë, se kemi çdo vit dëmtime.

**Enida Avdolli:** Faleminderit!Votohet dhe P-V Për dhënie ndihme financaire për familje në nevojë, me 23 vota pro.

**Floreta Zaçe:**Kam një informacion se kanditati i subjketi BF në Zvezdë është larguar si do veprohet? Nëse ka ndonjë të dhënë z.Server të flasë.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Ja lamë Kryesisë të merret me këtë.

**Enida Avdolli:**Mos u largoni, do doja një takim të shkurtër me përfaqësusen e Shoqatës unë gruaja, në lidhje me me dhunën ndaj femrave.Ftoj përfaqsuesen e shoqatës.

**Yllson Ibrahimllari:**Komisonet kur do mblidhen?

Përfaqësuejsa e Shqoqatës mban një fajlë shkurtër.

**Enida Avdolli:** Faleminderit! Kjo ishte mbledhja për sot.

**Mbajtës Protokolli**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Gertjan GJIRITI**

______________

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**

______________